



Titulli i projektit

Rikualifikim urban në Bashkinë e Sukthit

Tipi i projektit

Kohezion Social

Vendndodhja e projektit

Sukth

Buxheti i paravlerësuar

7,200 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Në Bashkinë e Sukthit pothuajse mungojnë hapësirat e përbashkëta për pushim dhe argëtim të komunitetit, si p.sh.: parqet, këndet e lojrave, hapësira kulturore dhe artistike, etj.. Zhvillimi urban i bashkisë i ka marrë komunitetit hapësirat e përbashkëta dhe privatizimi i ka kaluar ato në duart e operatorëve privatë. Kjo sigurisht ndikon negativisht në cilësinë e jetës së banorëve të kësaj bashkie dhe në humbjen e lidhjeve qytetare dhe të komunitetit. Po ashtu, ka ndikim negativ dhe në rritjen dhe edukimin e të rinjve.

Qëllimi/et specifik të projektit

Qëllimi i projektit është përmirësimi i situatës së infrastrukturës komunitare urbane në Bashkinë e Sukthit, e cila do të mundësojë krijimin e zonave të përbashkëta argëtuese për komunitetin, si p.sh.: parqe, kënde lojrash etj.. Kjo do të sjellë përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të Bashkisë Sukth.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- (a) krijimi i zonave të përbashkëta argëtuese për komunitetin;
- (b) përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit.

Rikualifikimi urban dhe krijimi i zonave të përbashkëta argëtuese do të ndikojë në përmirësimin e jetës së 15966 banorëve të Sukthit. Numri i njësive administrative që përfitojnë nga kjo ndërhyrje është 1 (një).

PROJEKTI 6



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt për zbatimin e rikualifikimit urban është 16 muaj.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë:

- (a) vlerësimin teknik të hapësirave ekzistuese;
- (b) përgatitjen e termave të referencës dhe të preventivave për ndërhyrjen rikualifikuese;
- (c) prokurimin dhe tenderimin;
- (d) kontraktimin dhe kryerjen e punimeve të rikualifikimit.

Maturimi i projektit

Aktualisht nuk evidentohet kryerja e ndonjë studimi fizibiliteti për rikualifikimin urban të Bashkisë Sukth. Sidoqoftë, sheshet dhe objektet janë paracaktuar nga Bashkia.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burim i mundshëm finacimi janë fondet publike të njësisë administrative Sukth dhe/ose Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

Kostot e projektit

Kostot do të dalin pas përgatitjes së preventivave, por vlerësohen të jenë rreth 7,200 Euro.